Kronikë

Tiranë/ Lëvizte i armatosur në zonën e Laprakës, arrestohet 30-vjeçari! Me pistoletë në çantë, ishte pasagjer në makinë

Një 30 vjeçar është arrestuar nga polilica e Tiranës pasi u kap në makinë teksa po lëvizte me armë në zonën e Laprakës

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

[Sh.com] Redaksia
12 Tetor, 13:13 | **Përditesimi: 12 Tetor, 13:38**

Share

Tirane- Një 30 vjeçar është arrestuar nga poliica e Tiranës pasi u kap në makinë teksa po lëvizte me armë në zonën e Laprakës.Ndalimi i tij u bë pasi një informacion i mbërritur në polici kishte njoftuar për një person që qarkullonte i armatosur në zonën e Laprakës.

> *"Shërbimet e Policisë kanë ndaluar një automjet tip "Audi" me drejtues shtetasin Xh. S., dhe pasagjer shtetasin K. K. Gjatë kontrollit të çantës së shtetasit K. K., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë me 2 krëhra dhe municion luftarak' informoi sot policia.*

Operacioni u kodua "Fast" dhe u zhvillua nga Sektori i Forcës së Posaçme "Shqiponja" në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 3.

[Sh.com]
LEXO EDHE:
Tiranë/ Plagosi me thikë 60- vjeçarin në lokal, shkak konflikti i çastit! Arrestohet autori me precedentë penal (Emrat)

Gjatë operacionit u arrestua në flagrancë shtetasi K. K., 30 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

S.G/E.B/Shqiptarja.com

TAG: armembajtje pa leje | Tirane | laprake

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Shqipëria hap negociatat me BE për kapitullin 1, kur do ndodhë integrimi?

Brenda 2030 | Pas 2030 | Nuk e di

Lajme të tjera

Uran Butka: Takimi im me Aranit Çelën më 1992, si më kërcënoi prokurori i komunizmit! Pjesë nga libri 'Polemika'

Admirina Peçi

12 Tetor, 17:03

SHBA i dhuron AMP-së sistemin të çështjeve 1,2 mln USD

11 Tetor, 17:31

Përurohet shkolla 9-vjeçare 'Musine Kokalari' në Kombinat, kapacitet për 750 nxënës

11 Tetor, 15:55

Theu masën e arrestit dhe doli në protestë për të hedhur sërish tritol, gjykata fut në burg Sokol Bushkolën! Një tjetër protestues në pranga

Keti Banushi

11 Tetor, 12:02

Tiranë/ Zbardhet grabitja e çantës me 200 mijë euro në taksi, 4 gjeorgjianë në kërkim për vjedhjen tek ish blloku! Hynë nga Maqedonia e Veriut, motorin e blenë këtu (EMRAT)

11 Tetor, 10:33



Tiranë/ U kap me 2.1 kg kanabis, arrestohet në flagrancë 31- vjeçari

11 Tetor, 09:25

Tiranë/ Kthyen magazinën në shtëpi bari, ndërtuan tunel për tu ngjitur në katin e dytë mbi 'Kadastër' 7 në pranga, 1 në kërkim! Tre prej të arrestuarve punonjës të OSHEE-së (EMRAT)

11 Tetor, 08:24

Sulollari Group vjen me Showroom e parë në Paskuqan 1, brandet ndërkombëtare në Shqipëri! Panele diellore, kondicionerë e hidrosanitare

10 Tetor, 16:22

Hapet Xhamia e Namazgjasë! Rama e Erdogan presin shiritin! Presidenti turk: Më e madhja në Ballkan! Kryeministri: Zoti na ndihmoftë në rrugën ku duam të ngremë Flamurin e Skënderbeut!

10 Tetor, 16:07

'Pritëm 3 dekada', shikoni pamjet brenda Xhamisë së Namazgjasë! Përlotet Myftiu i Tiranës

10 Tetor, 15:39

Pushkë, tritol e granata në banesë, zbulohet municion luftarak në fshatin Kus të Tiranës! Një i arrestuar (VIDEO)

10 Tetor, 08:27

Ish-deputeti sinjalizon policinë për një 'shtëpi bari', kati i parë pronë e kadastrës, mbi të laboratori i drogës! Sekuestrohen 105 rrënjë kanabis, 6 të shoqëruar

10 Tetor, 08:18

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje